Në mbështetje të nenit 16, pika 16.1 dhe të nenit 32 pika 32.1 shkronja **e** të Statutit të Komunës së Prishtinës 01.nr.110 - 455, të dt.31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 26.11.2008, merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJETIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Gjykatës Kushtetuese në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas nenit 1 të këtij Vendimi, përfshin pjesën e ngastrës kadastrore nr. 6039/1, Zona kadastrore Prishtinë, fleta poseduese nr. 1901, në një sipërfaqe prej 37 arë e 27 m^2, pronë shoqërore - ish Sekretariati i Punëve të Brendshme Prishtinë.

Neni 3

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit në lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e ndërtimit të objektit investiv, për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Ky Vendim hyn ne fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. Nr.35-1773, më 26.11.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof.dr. Isa Mustafa